VENDIM
Nr. 313, datë 11.5.2022

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PËRBËRJEN E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT, SI DHE TË KRITEREVE, PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES DHE SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 14, të nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Dhënies së Granteve për Mbështetjen e *Start Up*-eve (në vijim "komisioni i vlerësimit"), si organ vlerësues për kërkesat e *start up*-eve dhe lehtësuesve për mbështetje me grant.

2. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të organizimit e funksionimit të komisionit të vlerësimit, përcaktimi i kritereve, procedurës së përzgjedhjes, rasteve të mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të anëtarëve, si dhe të masës së shpërblimit financiar të tyre.

II. PËRBËRJA E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT

3. Komisioni i vlerësimit të dhënies së grantit për mbështetjen e *start up*-eve dhe lehtësuesve kryesohet nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe përbëhet nga 4 (katër) anëtarë të tjerë të zgjedhur me mandat për periudhën e disbursimit të grantit maj–dhjetor 2022, me të drejtë rizgjedhjeje, si më poshtë vijon:

a) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për sipërmarrjen;

b) një anëtar i caktuar nga ministri përgjegjës për rininë dhe fëmijët;

c) një anëtar i caktuar nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim *(Albanian–American Development Foundation)*, nga sektori i sipërmarrjes që mbulon tematikën e *start up*-eve dhe ekosistemit;

ç) një anëtar ekspert nga ekosistemi i *start up*-eve.

4. Anëtari ekspert i ekosistemit, parashikuar në shkronjën "ç", të pikës 3, të këtij vendimi, do të përzgjidhet mbi bazën e një procesi transparent konkurrimi, pas shpalljes së thirrjes për ekspertë të publikuar në faqen e ministrisë përgjegjëse për sipërmarrjen.

Ministri përgjegjës për sipërmarrjen ngarkohet të hartojë termat e referencës, afatin e aplikimit dhe kriteret e thirrjes për ekspert, si dhe të menaxhojnë procesin e konkurrimit e të përzgjedhjes së ekspertit të parashikuar shkronjën "ç", të pikës 3, të këtij vendimi.

Ministri përgjegjës për sipërmarrjen shpall fitues 2 (dy) aplikantët e vlerësuar me pikët më të larta nga konkurrimi, fituesin e parë në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit dhe fituesin e renditur i dyti në cilësinë e zëvendësuesit, në rastin e krijimit të vakancës nga eksperti i parë.

5. Mandati i anëtarit të komisionit të vlerësimit mbaron në rastet e mëposhtme:

a) dorëheqje;

b) përfundim i mandatit të qëndrimit në detyrë;

c) mbushje e moshës së pensionit të pleqërisë;

ç) shkarkim;

d) vdekje e anëtarit.

6. Anëtari i komisionit të vlerësimit shkarkohet nga detyra në rastet e mëposhtme:

a) ndërprerje e marrëdhënies së punës me institucionin që përfaqëson;

b) dënim me vendim penal të formës së prerë;

c) kur bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;

ç) kur, me veprimet e tij, dëmton veprimtarinë e komisionit të vlerësimit dhe imazhin e institucionit përgjegjës për funksionimin e këtij komisioni.

7. Në rast vakance në pozicionin e anëtarit të komisionit të vlerësimit, ministri përgjegjës për sipërmarrjen njofton menjëherë institucionin përkatës për propozimin e anëtarit të ri.

Institucioni propozues duhet të zgjedhë dhe të komunikojë anëtarin e ri brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i ministrit.

Në rastin e vakancës së krijuar nga anëtari ekspert i ekosistemit, ministri përgjegjës për sipërmarrjen cakton anëtar të komisionit të vlerësimit fituesin e renditur i dyti, parashikuar në shkronjën "b", të pikës 4, të këtij vendimi.

III. ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT

8. Komisioni i vlerësimit mblidhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas mbylljes së thirrjes për aplikime nga *start up*-e dhe lehtësues të *start up*-eve.

9. Mbledhja e komisionit të vlerësimit është e vlefshme nëse në të janë të pranishëm të paktën 3 (tre) anëtarë.

10. Mbledhja e komisionit të vlerësimit drejtohet nga kryetari.

11. Vendimet merren me shumicë të anëtarëve të komisionit të vlerësimit të pranishëm në mbledhje. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Procesverbali i mbledhjes u komunikohet të gjithë anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje dhe nënshkruhet prej tyre.

12. Komisioni i vlerësimit ushtron detyrat e parashikuara në nenin 14, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *start up*-eve", dhe në aktin nënligjor të miratuar në zbatim të pikës 3, të tij.

IV. KOMPETENCAT E KOMISIONIT TË VLERËSIMIT

13. Komisioni i vlerësimit ushtron këto detyra dhe kompetenca:

a) shqyrton dhe vlerëson të gjitha aplikimet e mbërritura nga *start up*-et dhe lehtësuesit;

b) kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga aplikantët, atëherë kur gjykohet e domosdoshme për vendimmarrjen, nëpërmjet njësisë përgjegjëse për menaxhimin e grantit, pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen;

c) plotëson raportin vlerësues për çdo aplikim dhe anëtarët e tij japin pikët individuale;

ç) miraton nivelin e grantit për përfituesit *start up* ose lehtësues të *start up*-eve, bazuar në pikëzimin dhe vendimmarrjen e anëtarëve të komisionit të vlerësimit;

d) merr në shqyrtim rastet problematike të aplikimit, me kërkesë të njësisë përgjegjëse pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.

V. MASA E SHPËRBLIMIT

14. Shpërblimi i kryetarit dhe i anëtarëve të komisionit të vlerësimit është në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për mbledhje, por jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) pagesa në vit.

15. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

16. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 3 të këtij vendimi, të caktojnë dhe të komunikojnë anëtarin e tyre pranë ministrit përgjegjës për sipërmarrjen, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

17. Funksionimi i komisionit të vlerësimit u nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim.

18. Ngarkohen ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe institucionet e listuara në pikën 3 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama